

Zhvillohet Kongresi i XXII-të i INTOSAI-t



Në datat 5-11 dhjetor 2016, në Abu D’habi të Emirateve të Bashkuara Arabe zhvillohet Kongresi INCOSAI XXII i INTOSAI-t. Kongresi organizohet një herë në çdo tre vjet dhe është aktiviteti më i rëndësishëm i INTOSAI-t, Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit(SAI-t), e cila përmbledh 192 SAI anëtare dhe 5 vëzhguese.

Temat e Kongresit të XXII-të:

1. Si INTOSAI mund të kontribuojë në Axhendën 2030 të OKB-së për Zhvillim të Qëndrueshëm, duke përfshirë qeverisjen e mirë dhe forcimin e luftës kundër korrupsionit?

2. Profesionalizmi: çfarë mund të nxisë besueshmërinë e INTOSAI-t për ta bërë një organizatë më të shquar ndërkombëtare?

Kongresi do të diskutojë dhe miratojë strategjinë e re të zhvillimit të INTOSAI-t 2017-2022, përditësimin e plotë të standardit ndërkombëtar ISSAI 30, “Kodit të Etikës”, si dhe ISSAI të tjera të reja që kanë dalë nga praktikat e mira të punës audituese në të gjithë botën.

Një delegacion i KLSH, i përbërë nga z. Bujar Leskaj, Kryetar, z. Ermal Yzeiraj, Drejtor i Departamentit Juridik, të Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës dhe Muhamed Kavaja, Kryeauditues merr pjesë në punimet e INCOSAI XXII. Kongresi miratoi Deklaratën e Abu Dhabit.

Deklarata e Abu Dhabit

A. Prezantim

1. Mbledhur në Emiratet e Bashkuara Arabe në dhjetor 2016 në Kongresin e INCOSAI XXII, Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) miratoi Deklaratën e Abu Dhabit.

2. Deklarata e Abu Dhabit u hartua në bazë të rrethanave të mëposhtme:

- Së pari, procesi i planifikimit strategjik, rezultoi në një plan të ri strategjik për 2017-2022, me synimin për të rritur kontributin e SAI-ve në përfundimin e llogaridhënies dhe transparencës në menaxhimin financiar publik në të gjithë botën;
- Së dyti, rishikimi i statuteve të INTOSAI-t për t’i përshtatur ato me strukturën aktuale, strategjinë dhe objektivat, me qëllim që të përmbushin më mirë nevojat e anëtarëve dhe palëve të interesit;
- Së treti, miratimi nga OKB-ja i 17 Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) në kuadër të Axhendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, e cila përforcon nevojën dhe kërkesën për një auditim publik efektiv;
- Së katërti, ngritja nga Komiteti i Shkëmbimit të Njohurive të një Portalit të Përbashkët, për të lehtësuar shkëmbimin e dijeve; dhe së fundmi, miratimi nga INTOSAI i një kornize të re për prononcimet

profesionale, si pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të përmirësuar standardet e INTOSAI-t dhe procesin e vendosjes së standardeve.

B. Ofrimi i një zëri publik gjithëpërfshirës

3. Në Deklaratën e Pekinit në 2013, INTOSAI ka shprehur ambicien për të krijuar një zë global mbi auditimin publik. Kjo ambicie është ankoruar në strategjinë e re të miratuar 2017-2022 dhe i parashtron sfida organizatës sonë për të rritur impaktin.

4. Në një nivel global, INTOSAI është angazhuar për të forcuar traditën e saj të gjatë të bashkëpunimit me Kombet e Bashkuara. SDGs-ja i ofron INTOSAI-t një mundësi të rëndësishme për të thelluar më tej këtë marrëdhënie dhe për të siguruar që komuniteti i SAI-ve kontribuon me një zë në nivel global, rajonal dhe nën-rajonal mbi çështjet që lidhjet me Axhendën 2030 të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

5. INTOSAI po formalizon gjithashtu partneritetin me grupe kyçe të interesit. Për shembull, duke punuar përmes Komitetit Drejtues të Donacionit të INTOSAI për të koordinuar përpjekjet për zhvillimin e kapaciteteve, me qëllimin shkëmbimin e përvojave me komitetin e zhvillimit ndërkombëtar. INTOSAI planifikon që përgjatë viteve të forcojë më tej partneritetin me organizata ndërkombëtare, përfshirë ato që përfaqësojnë parlamentet, ministritë e financave, shoqërinë civile, grupet e biznesit dhe trupat profesionale.

C. Një kontribut me peshë në Axhendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm

6. Kongresi identifikoi rëndësinë dhe interesin në kryerjen e auditimeve dhe punëve rishikuese mbi SDGs-të, bazuar në katër qasje të ndryshme, siç janë shtjelluar në planin strategjik. Secila qasje do të mbështetet nga një kornizë përkatëse, e cila do të ndihmojë INTOSAI-n të përpilojë gjetjet kyçe nga puna e SAI-ve në këtë fushë. Mbi të gjitha, INTOSAI synon të shndërrohet në një zë të pavarur autoritativ mbi sfidat me të cilat përballlet komuniteti global në planifikimin dhe implementimin e SDGs si dhe në raportimin mbi progresin e tyre.

7. INTOSAI planifikon të ofrojë një feedback sistematik në komunitetin tonë mbi çështjet e auditimit, në lidhje me SDG, si qasjen, metodologjitë dhe rezultatet, me qëllim që të angazhohet, të informojë dhe të inkurajojë SAI-et që të realizojnë një punë efektive në këtë fushë. Sakaq, INTOSAI do të ofrojë analiza dhe hulumtime periodike për palët ndërkombëtare të interesit mbi auditimin dhe çështjet e llogaridhënies në lidhje me SDGs, bazuar në eksperiencën e përbashkët të SAI-ve. Këto iniciativa synojnë të jenë një demonstrim efektiv i rëndësisë dhe dobishmërisë së rolit të INTOSAI-t dhe output-it të organizatave anëtare.

8. Për të ndjekur ambiciet tona mbi Axhendën 2030 të Zhvillimit të Qëndrueshëm, INTOSAI do të formojë një grup ekspertësh që do t'i raportojë Komitetit Mbikëqyrës mbi Çështjet Emergjente (SCEI). Ky grup, që do të përbëhet nga ekspertë të brendshëm dhe të jashtëm, do të mbikëqyrë zhvillimin dhe zbatimin e kornizave. Grupi do të jetë reagues dhe fleksibël në punën e tij dhe do të përfshijë grupet e punës së INTOSAI-t dhe burime të tjera të përshtatshme dhe efektive.

9. Kongresi identifikoi objektivat kyçe si më poshtë për grupin e ekspertëve, që do të adresohen në periudhën deri në Kongresin XXIII-INCOSAI në 2019:

- Zhvillimi i kornizave për implementimin e katër qasjeve bazuar në iniciativat e SAI-ve dhe të një mekanizmi për monitorimin e progresit dhe mbledhjen e informacionit;

- Përmes këtyre kornizave, të mbështesë hartimin e SDG-ve mbi informacionin me cilësi të lartë dhe t'i bashkë-ndajë ato me komunitetin e SAI-ve; dhe
- Sigurimin e marrëdhënieve efektive me OKB dhe partnerë të tjerë të jashtëm, përfshirë raportimin e informacioneve dhe maksimizimin e vlerës në të ardhmen të simpoziumeve INTOSAI/OKB mbi këtë tematikë

10. Qëllimi përfundimtar i INTOSAI-t është të mbështesë SAI-et që të japin një kontribut me peshë në Axhendën 2013 dhe të përmirësojnë kështu jetën e qytetarëve në botë.

D. Profesionalizmi

11. Qytetarët janë përfituesit kryesorë të auditimit publik. Është detyrë e SAI-ve të performojnë me auditime cilësore dhe t'i ofrojnë qytetarëve me raporte që mbështesin transparencën, llogaridhënie dhe besimin në qeverisje. Vetëm puna e mirë mund të bëjë ndryshim e vërtetë në jetët e tyre. Për ata, INTOSAI duhet të avancojë ambiciet e profesionalizmit.

12. Profesionalizimi është procesi i vazhdueshëm me të cilën individët dhe organizatat e tyre përfitojnë një nivel të lartë pavarësie, ekspertize, kompetence, sjellje etike dhe cilësi, mbështetur në standardet profesionale.

13. Realizimi i një kontributi me peshë në Axhendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm kërkon një angazhim nga të gjitha trupat e INTOSAI-t, që të rrisin mbështetjen profesionale për të gjithë SAI-et dhe stafet e tyre, duke u mundësuar atyre që të japin produkte me cilësi dhe në kohë.

INTOSAI po adreson këtë çështje përmes tre iniciativave të mëdha:

- Forcimin e procesit të standard-bërjes së INTOSAI-t;
- Mbështetjen e profesionalizmit në nivel global, rajonal dhe të SAI-ve; dhe
- Shpалosjen e kornizës së matjes së performancës së SAI-ve.

Forcimin e standard-bërjes së INTOSAI-t

14. INTOSAI ka krijuar Forumin e Prononcimeve Profesionale (FIPP) dhe ka rishikuar procesin për kornizën e prononcimeve profesionale (IFPP). Ekspertët teknikë të FIPP kanë përgjegjësinë kryesorë për përmbajtjen, konsistencën dhe cilësinë e IFPP-së. FIPP e forcon INTOSAI-n si një hartues i standardeve ndërkombëtare dhe kontribuon në zhvillimin e standardeve të përshtatshme për auditimin e jashtëm publik.

15. Proceset e standard-bërjes së INTOSAI-t duhet të sigurojnë se SAI-et kanë akses në standardet ndërkombëtare të auditimit. Fokusi i vazhdueshëm në përmirësimin e cilësisë së prononcimeve profesionale dhe procesit të standard-bërjes do të ndihmojë të përmbushë misionin e INTOSAI-t për të përforcuar zhvillimin e kapaciteteve të SAI-ve. INTOSAI do të luajë një rol aktiv në promovimin e zbatimit të ISSAI-ve.

Profesionalizmi në nivel global, rajonal dhe SAI

16. INTOSAI, duke punuar ngushtësisht me Iniciativën e Zhvillimit (IDI), do të zgjerojë më tej përpjekjet në nivel global, rajonal dhe të SAI-ve për të mbështetur profesionalizmin e SAI-ve dhe stafit të tyre.

17. Në një nivel global, FIPP ka identifikuar nevojën për të forcuar përpjekjet e INTOSAI-t drejt kompetencave, aftësive profesionale, etikës, vlerave dhe sjelljes së audituesve në sektorin publik, në

kornizën e INTOSAI-t mbi prononcimet profesionale. Një task-force drejtuar nga CBC do të vazhdojë të eksplorojë alternativat më të mira për të krijuar një themel solid për përforcimin e kompetencave dhe aftësive të audituesve në sektorin publik.

18. Për të lehtësuar implementimin e produkteve teknike të arritur në një nivel global, është esenciale që organizatat rajonale të INTOSAI-t të vazhdojnë të luajnë një rol kyç në komunikimin nga niveli global në nivelin SAI dhe *vice versa*. Të shtata organizatat rajonale të INTOSAI-t, së bashku me strukturat e tyre nënrajonale, kanë qenë një pikë qendrore e zhvillimit të INTOSAI-t për tre vitet e kaluara. CBC ka krijuar Forumin Rajonal të Zhvillimit të Kapaciteteve, e cila i dedikohet angazhimit me organizatat rajonale dhe nën-rajonale.

19. Në nivelin e SAI-t, iniciativat e zhvillimit profesional nga institucionet individuale mbeten thelbësore për arritjen e niveleve të larta të profesionalizmit. Këto përfshijnë: implementimin rigoroz të standardeve të INTOSAI-t; forcimin e integritetit dhe etikës; dhe trajnimin e vazhdueshëm profesional për drejtuesit dhe stafin.

Shpalosja e kornizës së matjes së performancës së SAI-t

20. Në INCOSAI XXII, Korniza e Matjes së Performancës së SAI-t (PMF) u miratua për përdorim nëpërmjet INTOSAI-t, si një mjet për vlerësimin e bazuar në prova të performancës së SAI-t të dhe për identifikimin e mundësive për përmirësim. INTOSAI inkurajon përdorimin e kornizës, e cila është e aplikueshme për të gjitha tipet e SAI-ve, pavarësisht modelit të tyre organizativ, mandatit , kontekstit kombëtar dhe nivelit të zhvillimit.

E. Implementimi i Planit Strategjik të INTOSAI-t, 2017-2022

21. Organizata e planit të ri strategjik përfshin disa nga ambiciet e ngritura në Kongres dhe reflektoi Deklaratën e Abu Dhabit. Është e nevojshme për lidërsipin e INTOSAI-t që të adresojë sfidat e organizatës sonë që të përmbushë këto ambicie me efektivitet.

22. Bordi Drejtues, me asistencën e Komitetit të Përhershëm mbi Çështjet Emergjente, katër komitetet kyçe dhe Sekretariati i Përgjithshëm, luajnë një rol thelbësor në monitorimin e progresit në realizimin e planit strategjik.

23. SCEI do të monitorojë prioritetet e INTOSAI-t për të siguruar që të jenë të integruara në strategjitë e ndryshme të INTOSAI-t dhe programet sipas qëllimeve strategjike.

24. Në INCOSAI XXIII në 2019, raporti i llogaridhënies do të ofrohet mbi aktivitetet e ndërmarra dhe se deri në çfarë mase INTOSAI do të përmbushë objektivat e vendosura në planin strategjik.